



Artan BEKA shkollimin fillor dhe të mesëm e ka përfunduar në Mitrovicë. Ka vazhduar studimet në **Universitetin e Prishtinës- FXM**, Drejtimi: **Teknologji** në Mitrovicë .

Në vitin 2000 në **OSBE** në Mitrovicë është angazhuar Trajner në Njësinë e Hetimeve, pastaj me 2001 në **IOM** Mitrovicë në Departamentin e Komunikimeve, dhe në nëntor 2001 ka lënë **IOM**-in për të kaluar në **PTK** (Kompaninë më të suksesshme në atë kohë) në Njësinë e biznesit – **DardaNET**, në vendin e punës Administrator i sistemit të IT-së, pozitë të cilën e mban edhe tani pas 20 vitesh.

Që nga viti 2004 është certifikuar në **Microsoft** (mbi 25 provime), **CISCO**, **Comptia Server+**, **Learning Tree International**, **WIFI WKO**, etj

Gjatë karrierës profesionale nga viti 2001 deri me 2014 ka ndjekur trajnime të avancuara profesionale në fushën e IT-së, të përkrahur nga Posta dhe Telekomunikacioni I Kosovës (**PTK**), në:

- INFONOVA Internet Academy**, Graz-Austri ,
- Learning Tree International**, Londër- Britani e Madhe ,
- HP Education Services**, Sofje-Bullgari ,
- Algebra Training Centre**, Zagreb-Kroaci ,
- Semos Computer Education Center**, Shkup- Maqedoni e Veriut ,

Në vitin 2012 ka fituar bursë të studimeve në distancë nga **University of People** në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku në vitin 2016 ka përfunduar me sukses programet e studimeve 2 dhe 4 vjeqare Associate Degree dhe Bachelor Degree në shkenca kompjuterike, ku është shpallur student i dalluar -**Cum Lauda** me GPA 3.67.

Gjatë përvojës 20 vjeqare profesionale në Teknologjinë Informativë është angazhuar në projekte të ndryshme në Telekomini e Kosovës duke përfshirë Upgrade dhe Migrim të sistemeve të ndryshme, ku përpos punëve ditore ka menaxhuar projekte të vogla dhe të mesme në Telekomini e Kosovës ku edhe aktualisht është duke udhëhequr me menaxhimin e projektit të IT-së mbi licensimin e produkteve.

Që nga viti 2004 e deri më sot është Inxhinier i certifikuar i sistemeve në Microsoft.

Që nga viti 2007 e deri më sot është Trajner i certifikuar i Microsoft-it.

Që nga viti 2012 e deri më sot është Ekspert i certifikuar i Microsoft-it.

Angazhimi në projektet e jashtme :

Ka qenë i angazhuar në vitin 2009 në projektimin dhe implementimin e infrastrukturës së IT-së në Odën Ekonomike të Kosovës **OEK-Prishtinë**.

Në kompaninë **INOVATIVI-Prishtinë** është angazhuar nga viti 2013 si Menaxher i projekteve të IT-së.

Në vitin 2017 ka qenë i angazhuar si Konsulent dhe Senior Sistem Administrator në kompaninë gjermane **ABIDAT GMBH -Prishtinë**.

Në vitin 2018 ka qenë Menaxher i IT-së në **Shkollën Finlandeze** në Kosovë, ka themeluar dhe implementuar infrastrukturën complete të IT-së.

Gjithashtu ka qenë këshilltar teknik në kompaninë **KOS CODE- Prishtinë**.

Në Janar 2020 ka ndjekur trajnimin e organizuar nga OEK-GIZ për transformim digjital të ndërmarrjeve kosovare, të gjeneratës së parë të konsulentëve dhe është certifikuar në modulin e specializuar- Ekspert i certifikuar në modulin e Sigurisë së TI dhe kibernetike, nga **WIFI WKO** Vjene- Austri.

Ai vazhdon të ndjek risitë dhe zhvillimet e fundit të sigurisë dhe produkteve të IT-së në tregun botëror dhe posaçërisht në Cloud Computing ku tani së fundmi në vitin 2021 është certifikuar në **Microsoft Azure Security**.

Ai jeton me gruan dhe 3 femijët në Prishtinë. Flet dhe shkruan shumë mirë gjuhën angleze, ndërsa gjuhën gjermane e shkruan dhe kupton mirë.

Kontributin e tij në fushën e Teknologjisë Informative e vazhdon në Telekomini e Kosovës, por edhe jashtë Telekomit në projekte te vogla dhe të mesme në kompanitë vendore dhe ndërkombëtare.